



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.176

30 dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.992, datë 15.12.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.208, datë 24.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie ndihme financiare Qeverisë së Kosovës, për realizimin e projekteve të propozuara për komunën Graçanicë, Kosovë”.....	9893
Vendim i KM nr.993, datë 10.12.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës “Badelonjë e Re – Petran”, në komunën Petran, në qarkun e Gjirokastrës.....	9893
Vendim i KM nr.995, datë 3.11.2010	Për shpalljen “Rezervat natyror i menaxhuar” të ekosistemit natyror ligatinor të Patok – Fushëkuqe – Ishëm	9894
Vendim i KM nr.996, datë 10.12.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.234, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit elektrik 400/220/110 kV në Kashar”.....	9898
Vendim i KM nr.997, datë 10.12.2010	Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit.....	9901
Vendim i KM nr.1000, datë 10.12.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Sult të qarkut të Elbasanit.....	9902
Vendim i KM nr.1001, datë 10.12.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Arras të qarkut të Dibrës.....	9903
Vendim i KM nr.1002, datë 10.12.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Zapod të qarkut të Kukësit.....	9904
Vendim i KM nr.1003, datë 10.12.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rashbull të qarkut të Durrësit.....	9905

Vendim i KM nr.1004, datë 10.12.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ostren të qarkut të Dibrës.....	9906
Vendim i KM nr.1005, datë 10.12.2010	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektin e qarkut të Vlorës e administratën e prefektit dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (PMNZSH).....	9907
Vendim i KM nr.1006, datë 10.12.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Qemal Stafa”, në bashkinë e Bilishtit.....	9910
Vendim i KM nr.1007, datë 10.12.2010	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë, të pronës nr.6 “Palestër e Repartit Renea, Tiranë”, për një ndryshim në vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Rendit Publik”, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.203, datë 5.4.2006 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objekteve reparti, komanda, palestra dhe poligoni të repartit Renea, Tiranë, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë”.....	9911
Vendim i KM nr.1008, datë 10.12.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të pronës nr.606 “Batalion zbulimi” (ish-BAM-i) në Libohovë, Gjirokastrë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”...	9914
Vendim i KM nr.1009, datë 10.12.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të rrjetit kombëtar me brez të gjerë në Republikën e Shqipërisë (National Broadband Network).....	9916
Vendim i KM nr.1011, datë 10.12.2010	Për miratimin e formatit tip të aktit të bashkëpronësisë.....	9916
Vendim i KM nr.1013, datë 10.12.2010	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)	9923
Vendim i KM nr.1016, datë 10.12.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, për nënprefekturën Kavajë, të disa mjediseve e të truallit funksional, me sipërfaqe 12 313.55 m ² , e kalimin në pronësi të bashkisë Kavajë të disa mjediseve e të truallit funksional, me sipërfaqe 71 967.82 m ² , komponentë të pronës nr.353 “Shtabi i repartit ushtarak nr.8832”, Kavajë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	9924
Vendim i KM nr.1036, datë 10.12.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar	9928

VENDIM
Nr.992, datë 15.12.2010

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.208, DATË 24.3.2010 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË KOSOVËS, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PROPOZUARA PËR KOMUNËN GRAÇANICË, KOSOVË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.208, datë 24.3.2010 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“2. Kundërvlehtë në lekë për 200 000 (dyqind mijë) euro t’i shtohet buxhetit të miratuar për vitin 2010, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për t’u përdorur në formën e transfertës.”.
 2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:
“2/1. Fondet e pashpenzuara prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, për vitin 2010, të përdoren nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rimbursimin e TVSH-së për kontratat e financuara nga IPA-ja, 2008.”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.993, datë 10.12.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI DHE
ASFALTIMI I RRUGËS “BADELONJË E RE – PETRAN”, NË KOMUNËN PETRAN, NË
QARKUN E GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës “Badelonjë e Re – Petran”, në komunën Petran në qarkun e Gjirokastrës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës së Petranit.
3. Pronarët e pasurive që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, dhënë në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 300 (treqind) m² tokë truall, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 240 000 (dyqind e dyzet mijë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e komunës së Petranit, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Petranit.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Petranit, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë 300 (treqind) m² tokë truall, shpronësuar në favor të komunës së Petranit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna e Petranit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN DHE ASFALTIMIN E RRUGËS “BADELONJË E RE-PETRAN”, NË KOMUNËN PETRAN, GJIROKASTËR

Nr.	Emër, mbiemër	Sip.m ² truall	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Dok. i pronësisë	Zona kadastrale
1.	Ylli Njazi Makollari	300	800	240 000	Certifikatë	1071
	Totali			240 000		

VENDIM
Nr.995, datë 3.11.2010

PËR SHPALLJEN “REZERVAT NATYROR I MENAXHUAR” TË EKOSISTEMIT NATYROR LIGATINOR TË PATOK – FUSHËKUQE – ISHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 4/2, 9, 13 e 23 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Rezervat natyror i menaxhuar” të ekosistemit natyror ligatinor të Patok – Fushëkuqe - Ishëm, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e këtij rezervati natyror të menaxhuar janë, si më poshtë vijon:

a) Veri:

Pika 1 me koordinata 4381044.06L e 4615097.92V, ndjek kufirin jugor të rezervatit natyror të menaxhuar Kune-Vain-Tale dhe krahun e djathtë të rrjedhës së lumit Mat deri te pika 2 me koordinata 4385013.69L e 4616775.65V, ndërpret lumin Mat, vijon përgjatë argjinaturës deri te pika 3 me koordinata 4386492.35L e 4616059.14V;

b) Lindje:

Pika 3 me koordinata 4386492.35L e 4616059.14V, vijon me rrugën automobilistike të Gurrëzit, me rrugën rurale dhe në krahun e djathtë të kanalit kullues në fshatin Gurrëzi, ndërpret kanalën e uzinës pranë fshatit Fushëkuqja (Kosovar), vijon përgjatë kanalit, drejt lindjes, më pas ndjek rrugën rurale të kanalit kullues pranë stacionit të pompimit të ujit, ndërpret rrugën kryesore për në Fushëkuqe, vijon në krah të kanalit kullues, në drejtim të jugut, ndërpret rrugën automobilistike të “Gjo Vatës” tek ura e ngushtë, vijon me kanalën kullues, ndërpret kanalën kryesor të Shëllinzës, sipër hidrovorit, vijon me kanalën kullues, ndërpret rrugën kryesore për në qendrën e Adriatikut, ndjek kanalën kullues në drejtim të lumit Drojë, vijon në krahun e djathtë të rrjedhës së lumit Drojë deri tek ura e Drojës pika 4 me koordinata 4382857.27L e 4605112.75V;

c) Jug:

Ura e Drojës pika 4 me koordinata 4382857.27L e 4605112.75V, ndërpret lumin Ishëm dhe vijon në krahun e majtë të rrjedhës së tij deri në grykëderdhje te pika 5 me koordinata 4379760.63L e 46055854.16V;

ç) Perëndim:

Pika 5 me koordinata 4379760.63L e 46055854.16V, vijon përgjatë bregdetit të detit Adriatik deri te pika 1 me koordinata 4381044.06L e 4615097.92 V.

3. Rezervati natyror i menaxhuar Patok-Fushëkuqe-Ishëm ka sipërfaqe të përgjithshme 5000.7 (pesë mijë pikë shtatë) ha, ku pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet ligatinore e lumenjtë, të ndjekura nga sipërfaqet bujqësore, pyjore, kullosore e me bimësi ujore, si dhe sipërfaqet urbane e troje të përziera me tokë bujqësore e pyjore, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Rezervati natyror i menaxhuar Patok-Fushëkuqe-Ishëm ndahet në nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Zona qendrore me sipërfaqe 634.8 (gjashtëqind e tridhjetë e katër pikë tetë) ha, e shënuar në hartë me ZQ, përfshin habitatet kryesore pyjore përgjatë lumit Mat, pyjet aluvionale, habitatet me kallamishte e bimësi ujore, pjesët e Lameve të Mëdha e të Vogla, pjesën e pyllit të Fushëkuqes dhe të Neglës, pjesët me bimësi ujore në grykëderdhjen e kanalit të Shëllinzës dhe ato ndërmjet pyllit të Neglës dhe lumit të Drojës të bashkimi me kanalin e Shëllinzës. Përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pasqetësuar.

b) Zona e përdorimit tradicional me sipërfaqe 2 420.0 (dy mijë e katërqind e njëzet pikë zero) ha, e shënuar në hartë me ZPT, përfshin tërësisht pjesët lagunore e detare të Patokut e të Godullës, pjesët ujore të lumenjve Mat e Ishëm dhe të shtretërve të vjetër, tokat me bimësi pyjore e ujore të Neglës, tokat bujqësore ku mundësohet vazhdimi vetëm i veprimtarive tradicionale, si: bujqësi, peshkim dhe pyje, me përdorim të balancuar të tyre, pasi të pajisen me leje mjedisore. Në këtë zonë nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, lagunave, të sistemeve të zonave të lagura dhe të pyjeve. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

c) Zona e rekreacionit me sipërfaqe 448.9 (katërqind e dyzet e tetë pikë nëntë) ha, e shënuar në hartë me ZR, përfshin pjesët e habitateve pyjore, ato me bimësi ujore dhe tokat e lagëta ndërmjet dy shtretërve të lumit Mat, pjesët ndërmjet grykëderdhjes së lumit Ishëm dhe Lumit të Vdekur deri te Godulla, dunat ranore të Patokut dhe pjesën e pyllit të Fushëkuqes. Në të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive turistike, si mundësi shëtitjeje në natyrë e lehtësi të tjera, në mënyrë të tillë që respekton funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat e saj ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor, në mbështetje të studimeve urbanistike të miratuara nga KRRTSH-ja.

ç) Zona e zhvillimit të qëndrueshëm me sipërfaqe 284.0 (dyqind e tetëdhjetë e katër pikë zero) ha, e shënuar në hartë me ZZHQ, përfshin zonat urbane dhe trojet e përziera me tokë bujqësore e pyjore pranë qendrave të banuara në Alku, Gurrëzi, Fushëkuqe, Fushëkuqe (Vataj), Shëllinzë dhe pjesën e ndërtimeve të peshkatarëve, si dhe ish-godinat e plazhit të Patokut. Në këtë zonë lejohen veprimtari, të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe ushtrohen vetëm me leje mjedisore, që nuk bien ndesh me planin e menaxhimit, dhe sipas planeve të zhvillimit urban, të miratuara nga KRRTSH-ja. Në zonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

d) Zona buferike me sipërfaqe 1 213.0 (një mijë e dyqind e trembëdhjetë pikë zero) ha, e shënuar në hartë me ZB, është pjesë integrale e zonës së mbrojtur, e cila mundëson vazhdimin e veprimtarive ekonomike e sociale të qëndrueshme dhe përdorimin e balancuar të burimeve natyrore. Veprimtaritë e reja dhe infrastruktura mund të ushtrohen vetëm me leje mjedisore dhe sipas studimeve urbanistike të miratuara, duke mos inkurajuar zhvillime ekonomike e sociale në tokat e lagëta me vlera për biodiversitetin. Në këtë zonë përfshihen pjesa bujqësore, ekonomike dhe urbane nga Fusha e Gurrëzit, Fushëkuqja (Kosovar), pjesët e Gorresë, Fusha Bishti i Fllugajve, ato të Adriatikut deri te lumi i Drojës. Në zonën buferike zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me ministrinë e tjera të linjës, njësitë e qeverisjes vendore, institucionet kërkimore-shkencore, organizatat jofitimprurëse, përfaqësuesit e biznesit dhe pronarët privatë, merr masa për të hartuar planin e menaxhimit të rezervatit natyror të menaxhuar.

6. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në bashkëpunim me ministrinë e tjera të linjës, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat jofitimprurëse, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe pronarët privatë, harton studimin urbanistik për zhvillimet urbane e turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe kontrollin e ndërtimeve, të cilat gjenden brenda sipërfaqes së rezervatit natyror të menaxhuar.

Veprimtaritë turistike dhe infrastruktura në zonën ndërmjet dy shtretërve të lumit Mat, ushtrohen vetëm me leje mjedisore dhe sipas vendimit të KRRTSH-së nr.18, datë 21.7.2009 “Për miratimin e

studimit urbanistik për zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e bregut të zonës turistike të Gjirit të Drinit”, dhe rregullores përkatëse.

Për veprimtaritë turistike të zbatohen kriteret dhe standardet e përcaktuara në ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Për rastet e trashëgimisë kulturore, veprimtaritë mundësohen me leje të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9806, datë 17.9.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike””.

7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministritë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore të rishikojnë lejet që kanë dhënë për veprimtari ekonomike e shoqërore, të cilat gjenden brenda sipërfaqes së rezervatit natyror të menaxhuar. Subjektet e pajisura me lejet përkatëse do të vazhdojnë të ushtrojnë këtë veprimtari, nëse nga pikëpamja ligjore përmbushin kriteret e ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, si dhe kur janë në përputhje me synimet dhe objektivat e menaxhimit të rezervatit natyror.

8. Autoritet shtetëror, që ngarkohet me administrimin e zonës së mbrojtur, janë strukturat e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ndërsa administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur Patok-Fushëkuqe kryen funksionet e administratës së rezervatit natyror të menaxhuar të Patok-Fushëkuqe-Ishëm.

9. Ngarkohen, sipas përkatësisë, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Sasia e sipërfaqeve sipas përbërjes

Tabela

Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja në ha
1.	Sipërfaqe pyjore, shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore dhe ujore	1 520.5
2.	Sipërfaqe kullosore e livadhe	296.0
3.	Sipërfaqe bujqësore (arë, pemëtoje, vreshta)	1 764.7
4.	Sipërfaqe ujore (detare, lumenj, ligatina, kanale kulluese ujitës)	913.7
5.	Sipërfaqe joprodhuese (ranore, zhavorrishte e zhveshur)	81.8
6.	Sipërfaqe urbane dhe troje të përziera me tokë bujqësore dhe pyjore	424.0
	Sipërfaqe e përgjithshme	5 000.7

VENDIM
Nr.996, datë 10.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.234, DATË 6.3.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
NËNSTACIONIT ELEKTRIK 400/220/110 KV NË KASHAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.234, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Masa e shpërblimit të pronarëve, për pasuritë pronë private, me sipërfaqe 105 000 (njëqind e pesë mijë) m² tokë/arë, truall, banesë, ndërtim industrial është 341 563 124 (treqind e dyzet e një milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e katër) lekë.”.

2. Lista e pronarëve që shpronësohen, e cila i bashkëlidhej vendimit, zëvendësohet me listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE NENSTACIONI ELEKTRIK 400/220/110 Kv "TIRANA 2"

RRETHI: TIRANE
KOMUNA: KASHAR

Lloji I pasurise se palujteshme qe shpronesohet: Are,truall,banese,ndertim industrial

Lloji I pasurise qe demtohet per shkak te ndertimit :Kultura bujqesore,te mbjella,strukture vreshti,ullinj

N/r	OBJEKTI	Emri	Atesia	Mbledhja	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Shpronesimi definitiv					Shpronesim provizor					Adresa e pronarit	SHENIME
							Sasia e sip. pronies m2	Sasia shpronesimi m2	cmimi shite ZRPP lek/m2	Vlera kompesimit	Sasia ne m2	Lloji i kulture bujqesore	vlera ne lek per ha	vlera ne lek per kulturen	Vlera totale kompesimit ne lek			
1	nst 400	Bedri	Ibrahim	Murati	Are	2105	24/17	1,700	1,700	2500	4,250,000	1,700	jonxhe	71,000	12070	4,262,070	Kashar	Certifikat
2	nst 400	Figuri	Ibrahim	Murati	Are	2105	24/18	1,613	1,613	2500	4,032,500	1,613	jonxhe	70,000	11291	4,043,791	Kashar	aplikuar per regjistrim
3	nst 400	Barjam	Mustafa	Sula	Are	2105	24/8	3687	3308	2500	8,270,000	3308	jonxhe	71,000	23486.8	8,293,487	Kashar	Certifikat(pa konfirmuar)
4	rug	Barjam	Mustafa	Sula	Are	2105	24/1	2000	491	2500	1,227,500	491	jonxhe	71,000	3486.1	1,230,986	Kashar	Certifikat(pa konfirmuar)
5	nst 400	Hanza	Sali	Dema													Kashar	Ska info
6	nst 400	Skender	Sali	Dema													Kashar	Ska info
7	nst 400	Pelrit	Sali	Dema													Kashar	Ska info
8	nst 400	Ymer	Ymer	Sula	Are	2105	24/9	10 037	9042	2500	22,605,000	9042	jonxhe	69 000	62,390	22 667 390	Kashar	Ska info
9	nst 400	Xhemal	Ymer	Sula													Kashar	Ska info
10	nst 400	Osman	Ymer	Sula													Kashar	Ska info
11	nst 400	Latif	Ymer	Sula													Kashar	Ska info
12	nst 400	Zija	Rexhep	Hoxha	Are	2105	24/15	2050	2050	2500	5,125,000	2050	ndrysh	75 000	15,375	5,140,375	Kashar	Certifikat
13	nst 400	Zija	Rexhep	Hoxha	Are	2105	24/16	3994	3994	2500	9,985,000	3994	ndrysh	115 000	45,931	10 030,931	Kashar	Certifikat
14	nst 400	Vait		Hoxha	Are	2105	24/15										Kashar	Certifikat
15	nst 400	Shyqyri	Hasan	Hoxha	Are	2105	24/13	3447	3447	2500	8,617,500	3447	jonxhe	72 000	24,818	8,642,318	Kashar	Certifikat(nuk gjenden referencat)
16	nst 400	Jemin	Ramazan	Hoxha	Are	2105	24/20	5062	5062	2500	12,655,000	5062	ndrysh	110 000	55,882	12,710,882	Kashar	Ska info
17	nst 400	Jemin	Ramazan	Hoxha	Truall	2105	24/7	275	275	12857	3,535,675	275	ndrysh	110 000	3,025	3,538,700	Kashar	Ska info
18	nst 400	Myrteza	Ramazan	Hoxha	Are	2105	24/19	5000	5000	2500	12,500,000	5000	jonxhe	69 000	34,500	12,534,500	Kashar	Certifikat
19	nst 400	Kalem	Ramazan	Hoxha	Are	2105	24/12	3375	3375	2500	8,437,500	3375	jonxhe	71,000	23,963	8,461,463	Kashar	Certifikat
20	nst 400	Kalem	Ramazan	Hoxha	Are	2105	26/5	2125	2125	2500	5,312,500	2125	jonxhe	71,000	15,088	5,327,588	Kashar	Certifikat(pa tap)
21	nst 400	Sadik	Ramazan	Hoxha	Are	2105	26/6	5375	5375	2500	13,437,500	5375	jonxhe	70 000	37,625	13,475,125	Kashar	Ska info
22	nst 400	Arben	Daut	Shehu	Are	2105	26/2/2	2840	1006	2500	2,515,000	1006	hasell	55,000	5,533	2,520,533	Kashar	Certifikat
23	nst 400	Gezim	Hyzen	Smaqi	Are	2105	26/2/1	1820	627	2500	1,567,500	627	hasell	62,000	3,887	1,571,387	Kashar	Certifikat
24	nst 400	Lutfi	Qamil	Hoxha	Are	2105	32/4	3080	779	2500	1,947,500	779	jonxhe	71,000	5,531	1,953,031	Kashar	Certifikat (me dubiklat)
25	nst 400	Veiz	Jashar	Dema	Are	2105	32/3	4500	4500	2500	11,250,000	4500	ndrysh	112 000	50400	11,300,400	Kashar	Ska info
26	nst 400	Halim	Zyber	Dema	Are	2105	32/2	3375	3375	2500	8,437,500	3375	ndrysh	63,000	21,263	8,458,763	Kashar	Ska info
27	nst 400	Halim	Zyber	Dema	Are	2105	32/1	6406	6406	2500	16,015,000	6406	jonxhe	72 000	46,123	16,061,123	Kashar	Kerkesa per Ap per certifikate
28	nst 400	Xhavit	Xhemal	Hoxha	Are	2105	33/1	1170	1170	2500	2,925,000	1170	ndrysh	100 000	11,700	2,936,700	Kashar	Certifikat(me dubiklat)
29	nst 400	Halim	Zyber	Dema	Are	2105	33/2	675	675	2500	1,687,500	675	jonxhe	72 000	4,860	1,692,360	Kashar	Ska info
30	nst 400	Agim	Abdulla	Dema	Are	2105	33/3	2725	588	2500	1,470,000	588	perime	120 000	7,056	1,477,056	Kashar	Certifikat
31	nst 400	Bedri	Ibrahim	Murati	Are	2105	25/3	2600	2600	2500	6,500,000	2600	jonxhe	70 000	18,200	6,518,200	Kashar	Certifikat(me dubiklat)
32	nst 400	Figuri	Ibrahim	Murati	Are	2105	25/4	1400	1400	2500	3,500,000	1400	jonxhe	70 000	9,800	3,509,800	Kashar	aplikuar per regjistrim
33	nst 400	Ilir	Barjam	Nurce	Truall	2105	25/2	2100	2100	12857	26,988,700	0		70 000	9,800	26,999,700	Kashar	Certifikat
34	nst 400	Ilir	Barjam	Nurce	ndertim	2105	25/2	1371	1371	45500	62,380,500	0			0	62,380,500	Kashar	Certifikat

Nr	OBJEKTI	Emri	Atesia	Mbledhja	Lloji i pasurisë	Nr. Kadast. rral	Sasia e sip. pronës m ²	Sasia shpronësimit definitiv m ²	çmimi shpirt. ZRPP lek/m ²	Vlera kompesimit	Sasia m ²	Lloji i kultures bujqesore	vlera ne leke per fha	vlera ne leke per kulturen	Vlera totale kompesimit ne leke	Adresa e pronarit	SHENIME
35	nst 400	Rakip	Haxhi	Demra	Are	2105	26/4/2	4844	2500	1,977,500	791	ndrysh	74,000	5,853	1,983,353	Kashar	Ska info
36	nst 400	Abdyri	Haxhi	Demra	Are	2105	26/4/3	5187	2500	2,807,500	1123	hasell	64,000	7,187	2,814,687	Kashar	Ska info
37	nst 400	Jakup	Ahmet	Sula	Are	2105	26/4/6	6300	2500	1,142,500	457	ndrysh	105,000	4,799	1,147,299	Kashar	Certifikat
38	nst 400	Jakup	Ahmet	Sula	Are	2105	26/4/5	2460	2500	6,150,000	2460	jonxhe	65,000	15,990	6,165,990	Kashar	Ska info
		Sadik	Ramazan	Hoxha													Ska info
38	nst 400	Pa emer			Are	2105	26/4/5	2460	2500	6,150,000	2460	jonxhe	65,000	15,990	6,165,990	Kashar	Ska info
39	nst 400	Behar	Shefqet	Sula	Are	2105	11	12500	2500	1,535,000	614	jonxhe	74,000	4,544	1,539,544	Kashar	Ska info
40	nst 400	Xhemal	Haxhi	Demra	Are	2105	26/4/1	7500	2500	1,175,000	470	hasell	63,000	2,961	1,177,961	Kashar	Certifikat
41	nst 400	Bilal	Rustem	Murati	Are	2105	120/1	1875	2500	1,922,500	796	hasell	66,000	5,254	1,927,754	Kashar	Certifikat(fotokopie)
42	nst 400	Peitrit	Ibrahim	Vallisi	Are	2105	1120/22	2400	2500	1,372,500	549	ndrysh	69,000	3,788	1,376,288	Kashar	Certifikat
43	nst 400	Yvi	Hasan	Murati	Are	2105	1118/6	5000	2500	482,500	185	jonxhe	58,000	1,258	463,758	Kashar	Certifikat(lapia me dubikate)
44	nst 400	Pa emer			Are	2105	1118/7	4288	2500	395,000	158	jonxhe	68,000	1,074	396,074	Kashar	Ska info
45	nst 400	Kasem	Daut	Hajdari	Are	2105	1118/1	4750	2500	702,500	281	jonxhe	69,000	1,939	704,439	Kashar	Kerkese per Ap per certifikate.
46	nst 400	Muhamed	Qerim	Sula	Are	2105	1118/2	2468	2500	307,500	123	jonxhe	69,000	849	308,349	Kashar	Certifikat
47	nst 400	shtet			kanal	2105	441			0	0			0	0	Kashar	
48	nst 400	shtet			kanal	2105	683			0	0			0	0	Kashar	
49	nst 400	shtet			kanal	2105	673			0	0			0	0	Kashar	
50	nst 400	shtet			ruge	2105	26/1			0	0			0	0	Kashar	
51	nst 400	Sadik	Ramazan	Hoxha	shtepi	2105	26/6	113.6	41500	4,714,400	113.6	-		0	4,714,400	Kashar	Ska info
52	nst 400	Njazi	Sadik	Hoxha	shtepi	2105	26/6	120	41500	4,980,000	120	-		0	4,980,000	Kashar	Ska info
53	nst 400	Rasim	Jemin	Hoxha	shtepi	2105	24/20	74	41500	3,071,000	74	-		0	3,071,000	Kashar	Ska info
54	nst 400	Rustem	Bilal	Murati	are	2105	119/4	10000	2500	25,000,000	10000			0	25,000,000	Kashar	Certifikat
55	nst 400	Bilal	Rustem	Murati	Are	2105	119/5	8682	2500	8,760,000	3504			0	8,760,000	Kashar	Certifikat(lapia fotokopie)
56	nst 401	shtet					119/2.3	3272									
58	239/A	Behar	Shefqet	Sula	Are	2105	11	12500	2500	150,000	1600	jonxhe	69,000	11,040	161,040	Kashar	Ska info
59	241/1	Behar	Shefqet	Sula	Are	2105	11	12500	2500	150,000	1600	jonxhe	69,000	11,040	161,040	Kashar	Ska info
60	241/2	pretendim pronesia				2105	6/3		2500	150,000	1600	jonxhe	69,000	11,040	161,040	Kashar	Ska info
61	241/3	Grigor	Spiro	Lengo	Are	2625	2/6	2200	2500	150,000	1600	jonxhe	69,000	11,040	161,040	Kashar	Ska info
62	241/4	Naim	Beqir	Mici	Are	2625	16/28	2400	2500	150,000	1600	jonxhe	69,000	11,040	161,040	Kashar	Certifikat
63	241/5	pretendim pronesia				2105	x14		2500	150,000	1600	jonxhe	69,000	11,040	161,040	Kashar	Ska info
64	241/6	Nazmi	Qamil	Sula	Are	2105	107/11	8600	2500	150,000	1600	jonxhe	69,000	11,040	161,040	Kashar	Certifikat(lapia fotokopie)
															341,563,124	leke	
															105000 m2		

VENDIM
Nr.997, datë 10.12.2010

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË QENDRËS SË PUNËS, BRENDË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit.

II. Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në kuptim të këtij vendimi, përfshihen:

1. njësitë e qeverisjes qendrore, që janë: njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave;

2. njësitë e qeverisjes vendore, që janë njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj;

3. njësitë e fondeve speciale, që janë njësitë e krijuara me ligje specifike.

III. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit, bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës, si më poshtë vijon:

1. Për shërbime në një largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.

2. Përfshihen nga pika III-1, punonjësit e Policisë së Shtetit, punonjësit e Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, kur marrin pjesë në shërbime operacionale. Në këto raste, këta punonjës trajtohen sipas pikës III-3 të këtij vendimi.

3. Për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, punonjësit i përballohen shpenzimet e mëposhtme:

a) Dietë ditore, e cila për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet:

i) në masën 1000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës;

ii) në masën 10 për qind të pagës mujore, por jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë.

b) Shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë, për çdo natë.

c) Shpenzimet e transportit në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.

IV. Dokument tatimor, për efekt të këtij vendimi, do të konsiderohet çdo biletë transporti e miratuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe çdo faturë e thjeshtë apo me TVSH, e cila detyrimisht duhet të shoqërohet me faturë të printuar nga kasa elektronike fiskale.

V. Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga:

1. Titullari i njësisë shpenzuese për shërbimet me largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës.

2. Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Titullarë institucioni qendror, në kuptim të këtij vendimi, janë:

a) Për njësitë e qeverisjes qendrore:

i) për ministrinë dhe çdo institucion në varësi të saj, ministri ose i deleguari i tij;

ii) për aparatet e Presidencës, të Kuvendit, të Këshillit të Ministrave, të enteve kushtetuese, si dhe për institucionet në varësi të Kryeministrit, sekretari i përgjithshëm përkatës;

iii) për punonjësit e gjykatës, kryetari i gjykatës.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore, kryetari njësisë vendore.

c) Për fondet speciale, titullari i fondit special.

VI. Prefektët e qarqeve që kryejnë funksione larg vendbanimeve të tyre, kur nuk u janë siguruar kushtet për fjetje pranë vendit të punës, përfitojnë dietë dhe u paguhen shpenzimet e ditës sipas pikës III-3 të këtij vendimi për një periudhë jo më shumë se një muaj. Pas një muaji nga data e emërimit të tij, shpenzimet e fjetjes, por jo më shumë se 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj përballohen nga vetë institucioni urdhërues, deri në momentin e sigurimit të një banese.

VII. Studentët dhe nxënësit, si dhe trupa shoqëruese pedagogjike, që kryejnë praktika mësimore, ekspozita apo veprimtari jashtë qendrës së institucionit arsimor publik, nuk përfitojnë dietë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes së tyre përballohen nga institucionet përkatëse të arsimit, sipas dokumenteve përkatëse tatimore, të përcaktuara në pikën IV të këtij vendimi.

VIII. Vendimi nr.228, datë 13.4.2001 i Këshillit të Ministrave “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, të ndryshuar, si dhe çdo vendim apo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1000, datë 10.12.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SULT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Sult të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Sult të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.925, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Sult të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Sult për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
11-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
14-45	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
46-59	Varrezat publike	Në pronësi
60-89	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
351,353,355,356,359, 361,362	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produkteve)	Në përdorim
352,354,357,358,360	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në përdorim
378-394,396-441	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
443	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM**Nr.1001, datë 10.12.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS ARRAS TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Arras të qarkut të Dibrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 33 (tridhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 204 (dyqind e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Arras për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
19	Prona që përdoren në fushën social-kulturore dhe sportive	Në pronësi
20-36	Varreza publike	Në pronësi
172-197	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
137, 138, 140, 141, 143, 144, 146, 148, 149, 151, 152, 154, 155, 157, 158, 160, 161	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
139, 142, 145, 147, 150, 153, 156, 159, 162, 163-170 (Vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
198, 199	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM**Nr.1002, datë 10.12.2010**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ZAPOD TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Zapod të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zapod të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.37, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zapod të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zapod për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
6-7, 10-11, 13-14, 16-17, 19-21, 23-25, 27-28	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
8-9, 12, 15, 18, 22, 26, 29	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
30	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën shëndetit publik	Në pronësi
34-35	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
70-74	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
85-109	Varreza publike	Në pronësi

VENDIM**Nr.1003, datë 10.12.2010**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS RASHBULL TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rashbull të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Rashbull të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.1153, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Rashbull të qarkut të Durrësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Rashbull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Sali Berisha**

Komuna Rashbull

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
18-31	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
32-45	Varreza publike	Në pronësi
46-51	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

94, 99, 105, 109, 110, 111, 113-116	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
-------------------------------------	---	------------

VENDIM
Nr.1004, datë 10.12.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS OSTREN TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ostren të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

